



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr.924/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët Ferki Xhaferi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkritazi me apelin e Subjekti Politik Nisma Social Demokrate, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Drenasit, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Pranohet** i bazuar apeli Anr.924/2021 i datës 04.11.2021, nga Subjekti Politik Nisma Social Demokrate, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Drenasit, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal,

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimin për Kandidat për Kuvend Komunal nga Nisma Social Demokrate, në Komunën e Drenasit, në Vendvotimin 0314E/02D.

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.924/2021 të paraqitur nga Subjekti Politik Nisma Social Demokrate, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Drenasit, me të cilën pretendon se në vendvotimin 0314E/02D, ka pasur parregullsi pasi që ka parregullsi sepse nuk përputhen votat e kandidatëve me votat e subjektit. Kërkon rinumërimin e votave për këtë rinumërim.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura, në apel në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

## Apeli është i bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, subjekti Politik Nisma Social Demokrate, kërkon rinumërimin e votave në vendvotimin e lartcekur, PZAP, pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga subjekti në fjalë, për rinumërimin e votave për vendvotimin e lartcekur është i bazuar.

Paneli vlerëson se apeli është mbështetur në provat e dorëzuara nga kandidati, ku shihet qarte se nga formularët e bashkangjitur me apel rezulton fakti se ka mospërputhje në formular, ku subjekti ka gjithsej 03 vota ndërsa kandidatët kanë 5 vota gjë që procesin e bartjes së votave gjatë numërimit në formularë në vendvotimet e lartcekura e bënë të pa rregullt.


Andaj ky panel, vlerëson se rinumërimi në këtë vendvotim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli me qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësishtë e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze, gjithashtu në mbështetje të nenit 117.4 dhe po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur duke vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.*

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 924/2021 më datën 06.11.2021.

Kryesues i Panelit  
Ferki Xhaferi



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi.